



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenin 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019 dhe nenit 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), Komisioni shtetëror duke vepruar pas denoncimit nga parashtrues i panjohur, në senacën e 46-të të mbajtur me datë 12.02.2021, KSHPK morri

VENDIM

Akuzat nga denoncimi anonim me numër 09-744/1 me datë 22.02.2019 të cilat kanë të bëjnë me punësimin e personi në Spitalin klinik në, bashkëshorte e, Drejtori i SHA për menaxhim me hapsira banesore dhe afariste – filiala, vërtetohen, mirëpo punësimi është bërë në përputhje me nenin 161 nga Ligji për sigurim shëndetësor, ku është shfrytëzuar autorizimi diskreditiv nga ana e personave përgjegjës në Spitalin klinikë

Procedura për përcaktim të konfliktit të interesave në lidhje me rastin konkret nga dencimi **NDËRPRITET**.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të inteersave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshën kompetent në lëndën me numër 09-744/1 me datë 22.02.2019.

Lënda me numër 09-744/1 me datë 22.02.2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-744/1 me datë 22.02.2019 është formuar pas parashtrimit të denoncimit anonim, me akuza për ndikim të bërë për punësimin e personit në Spitalin klinik në, bashkëshorte e, drejtori i SHA për menaxhim me hapsira banesore dhe afariste – filiala.

Në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike në rastin konkret, në përputhje me nenin 76 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK u drejtua deri tek ISHP Spitali klinik për dorëzim të dokumentacionit të plotë për punësimin e personit

Pas dorëzimit të informacioneve dhe të dhënave nga institucioni i përmendur, KSHPK e caktori gjendjen faktike vijuese:

Pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e finansave me numër 18-11491/1 me datë 28.09.2018 për punësim të 119 personave ndër të cilët është edhe vendi i punës teknik farmaceutik, shpallur në konkursin publik me numër 04-2343/2 me datë 10.10.2018, ku për vendin e punës teknik farmaceutik kërkohet dy ekzekutorë. Më vonë është rishpallur konkursi publik me numër 04-2957/1 me datë 20.12.2018 ku përsëri për vendin e punës teknik farmaceutik kërkohet dy ekzekutorë. Me Vendim për formimin e Komisionin për selektim të punëtorëve të shëndetësisë dhe bashkëpunëtorëve pas rishpalljes së Konkursit publik me numër 04-2957/1 me datë 20.12.2018 është formuar komisioni i përmendur. Komisioni i përmendur për selektim ka përpiluar rang listë të kandidatëve të cilët kanë konkuruar në konkursin publik për teknik

farmaceutik nē ISHP Spitali klinik me numēr 02-318/2 me datē 04.02.2019, nga i cili mund tē shihet se pēr kētē vend tē punēs kanē konkuruar 9 persona, me ka sipas kriteriumeve tē caktuara: suksemi mesatar qē kandidati ka arritur nē shkollimin e mesēm ose tē lartē, provimi kualifikues i pērbērē nga dy pjesē dhe atē: pjesa profesionale (test) dhe njohja e njē gjuhe tē hauj, personi gjendet i ranguar nē vendin e tretē, kurse kandidatja tjetēr qē ēshtē pranuar nē vendin e njējtē tē punēs gjendet nē vendin e pestē tē rang listēs. Nē pērputhje me nenin 161 nga ligji pēr sigurim shēndetēsor, nenin 14 paragrafi 1, nenin 21, 22, 23 dhe 27 nga Ligji pēr marrēdhēnje pune, nē bazē tē dorēzimit tē rang lsitēs, Drejtori i ISHP Spitali klinik merr Vendim me numēr 02-331/1 me datē 06.02.2019 dhe nē vendin e punēs teknik farmaceutiki zgjedh kandidtēt dhe

Kundēr Vendimit me numēr 02-331/1 me datē 06.02.2019 personi (i ranguar nē pozitēn e katērt pēr vendin e punēs teknik farmaceutik) parashtroi ankesē me numēr 03-532/1 me datē 14.02.2019 deri tek Komisioni shtetēror pēr vendimmarrje nē procedurē administrative dhe procedurē pēr marrēdhēnje pune tē shkallēs sē dytē miratuar me Akt-vendim nr. 03-532/2 me datē 14.03.2019 se ankesa e personit rrefuzohet si e pa bazē me arsye qē nē pēruthje me nenin 161 nga Ligji pēr sigurim shēndetēsor organi punēdhēnēs i institucionit shēndetēsor ka tē drejtē diskrecione qē tē bēnē zgjedhje tē cilido qoftē nga kandidatēt e propozuar tē cilēt i plotēsojnē kushtet e shpallura nē konkurs. Komisioni shtetēror vērtetoi se Drejtori i ISHP Spitali klinik ka vepruar nē kuadēr tē ingirencave dhe autorizimeve tē cilat janē tē caktuara me ligj, nē mēnyrē tē rregullt e ka caktuar gjendjen faktike dhe nē mēnyrē tē rregullt ka aplikuar tē drejtēn materiale.

Nē seancēn e mbajtur me datē 12.02.2021, pas shqyrtimit tē tē gjitha akuzave tē lēndēs, KSHPK duke u nisur nga dispozitat e Ligjit pēr parandalim tē korrupsionit dhe konfliktit tē interesave konstaton se, tē ndërpritet procedura pēr vērtetim tē konfliktit tē interesave nē lidhje me akuzat pēr punēsim tē personit nē ISHP Spitali klinik pērshkak tē shfrytēzimit tē tē drejtēs diskreditive nga ana e drejtorit tē ISHP Spitali klinik dhe pēr shkak tē veprimit tē organit kompetent pas parashtrimit tē ankesēs tē njē nga kandidatēt e paraqitur nē konkursin e pērmendur pēr punēsim nē vendin e punēs teknik farmaceutik.

Nē bazē tē tē gjithē tē pērmendurēs mē sipēr, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vendosi sipas dispozitave tē kētij vendimi.

**KOMISIONI SHTETĒROР ПЃР
PARANDALIM TĒ KORRUPTIONIT**
Kryetarē: Biljana Ivanovska

Pas pērfundimit tē KSHPK
Pērpunoi: K. Z., kēshilltarē